



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1213/2 prot.,

Datë 30.05.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Ervin Luzi” Person Fizik në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-62412-03-15-2023 me objekt: “*Blerje tonera per printera dhe fotokopje per vitin 2023*”, me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26.04.2023 nga autoriteti kontraktor, *Bashkia Vau i Dejës*.

**Ankimues:** Operatori Ekonomik “Ervin Luzi” Person Fizik.  
Adresa: Lagja Katund i Ri, rruga “Ali Pashë Gucia”, Godina nr. 5, Yrshek, Kashar, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Vau i Dejës  
Adresa: Rruga Qafa e Gurit, Vau Dejes

Në datën 29.05.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1213 prot., datë 29.05.2023 e operatorit ekonomik “Ervin Luzi” person Fizik për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-62412-03-15-2023 me objekt: “*Blerje tonera per printera dhe fotokopje per vitin 2023*”, me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26.04.2023 nga autoriteti kontraktor, *Bashkia Vau i Dejës*.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Ervin Luzi” Person Fizik.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

*b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.*

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Ervin Luzi” Person Fizik kundërshton me anë të ankesës me nr. 1213 prot., datë 29.05.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

**Arsyet e skualifikimit:**

*Mostrat e paraqitura nga ana juaj ne ditën e hapjes se ofertave, jane paraqitur me etikete te ngjitur, ndryshe nga sa eshte kerkuar nga AK-ja, gjithashtu nuk jane origjinale , dukshem qe nga ambalazhimi i tyre*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 30.05.2023.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**